

URDHËR
Nr. 459, datë 12.10.2022

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË SHËNUAR DHE MASAT PËR KUFIZIMIN E
PËRHAPJES SË DËMTUESIT PËR VIRUSIN E RRUDHOSJES KAFE TË FRUTËS SË
DOMATES (ToBRFV)”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetur në pikën 2, të nenit 16, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e zonës së shënuar për dëmtuesin karantinor të virusit të rrudhosjes kafe të frutës së domates (ToBRFV), si më poshtë vijon:

Zonë e infektuar: Sipërfaqja prej 0.4 ha e mbjellë me spec në zonën kadastrale nr. 2834, me numër pasurie 98/14, e cila kufizohet me V 98/13, L 98/27, J 98/15, P 166 dhe ndodhet në fshatin Orman-Pojan, Bashkia Maliq.

Zonë sigurie: Zona 30 metra rreth zonës së infektuar.

2. Në zonën e shënuar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, të zbatohen masat për çrrënjosjen e virusit ToBRFV, si më poshtë:

a) Të gjitha bimët e infektuara, bujtëse dhe pjesët bimore të shkatërrohen me djegie ose groposje të thellë.

b) Makineritë, pajisjet (përfshirë veshjet dhe mjetet mbrojtëse) nuk duhet të largohen nga vendi i prodhimit. Në të kundërt të bëhet dezinfektimi i tyre. Mjetet (gërshërë, thika etj.) dezinfektohen në mënyrë të përsëritur.

c) Lëvizja e personelit nga zona e shënuar duhet të kufizohet. Larja dhe dezinfektimi i këpucëve, duarve etj. të kryhet menjëherë pas daljes nga zona e infektuar.

ç) Kompostoja në të cilin janë depozituar mbetjet e bimëve ose frutat e specave nuk duhet të përdoret në prodhimin e bimëve bujtëse.

d) Të zbatohen masat higjienike, kur lëvizet nga zona e infektuar.

dh) Ripërdorimi i paketimit (ambalazhet plastike, kuti etj.) të dezinfektohet përpara ripërdorimit.

e) Të bëhet qarkullimi bujqësor me bimë jobujtëse, të paktën për një periudhë kohore prej një viti.

ë) Gjatë periudhës njëvjeçare duhet të merren masat për të parandaluar mbirjen rastësore të bimëve të specit dhe të bimëve bujtëse.

f) Të bëhet plugim i thellë i tokës, jo më pak se 45 cm.

3. Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan vë në dijeni për këtë urdhër Bashkinë Korçë dhe operatorët profesionistë.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Dhimitër Kote